

PASQYRË E KRIMIT MJEDISOR



NË KËTË NUMËR DO TË LEXONI

- Shkarkime nafte në Porto Romano
- Nafta mbush lumin Gjanica
- Helmohen kafshë të egra
- Shkatërimi i habitateve në Munellë

RRETH GAZETËS

Kjo gazetë elektronike përmban raste të krimit mjedisor të raportuara nga mediat dhe shoqatat mjedisore dhe zhvillime rreth kësaj problematike në vendin tonë. Kjo gazetë është krijuar nga organizata mjedisore dhe anëtarë të grupit këshillues mbi krimin mjedisor në Shqipëri si një instrument për të grumbulluar dhe komunikuar raste specike të krimit mjedisor në ndihmë të autoriteteve ligjzbatuese.

KRIMET KUNDËR MJEDISIT DHE PËRGJIGJA GJITHËPËRFSHIRËSE E LUFTËS NDAJ TYRE

Pesë vite më parë, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri filloi të punojë me Ministrinë (asokohe) të Mjedisit, për çështjen e krimeve mjedisore në Shqipëri. Prezenca ndihmoi Ministrinë të krijonte një grup pune ndërinstitucional, në mënyrë që organet e ndryshme në vend, të cilat merreshin me krimin mjedisor, të mund të shkëmbejnë informacione, të ndërmerrnin veprime të përbashkëta dhe të propozonin ndryshime legjislative. Që atëherë janë zhvilluar 12 aktivitete në bashki të ndryshme për të rritur ndërgjegjësimin e publikut; është përgatitur një plan strategjik veprimi kundër krimit mjedisor për vitin 2018 - 2021 për grupin ndërinstitucional; është ofruar kontributi i ekspertëve në lidhje me ndryshimet legjislative që duhet të ndërmerren, dhe gjithashtu është hartuar një program mësimor trajnimi për Akademinë e Sigurisë.

Gjurmët e krimit mjedisor janë të dukshme në vend. Po ashtu për fat të keq, nuk ka të dhëna të sakta dhe gjithëpërfshirëse. Vendit ende i mungon një sistem i unifikuar raportimi, parandalimi dhe ndjekje e krimeve të tilla. Sipas shifrave nga Prokuroria e Përgjithshme të vlefshme për vitin 2019, pati vetëm 266 raste të referuara në këtë institucion, nga të cilat vetëm 66 raste u dërguan në Gjykatë dhe 48 u dënuan. Ne e dimë se vendi mbetet i prekur nga krimi mjedisor, i cili është nganjëherë shumë i organizuar dhe i sofistikuar, dhe për ta luftuar këtë krim nevojiten burime, bashkëpunim institucional, ndryshime legjislative dhe bashkëpunim me shoqërinë civile dhe aktivistët e mjedisit.

Për këtë qëllim, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri po mbështet punën e një "Grupi Këshillues" i cili sjell së bashku shoqërinë civile, akademikët dhe median për të bashkuar ekspertizën e tyre, të rrisë ndërgjegjësimin në nivelin lokal, dhe për të ndihmuar në avancimin e programit të qeverisë kundër krimeve mjedisore. Në këtë kontekst, Prezenca sheh prezantimin e një gazete të titulluar "Pasqyra e Krimit Mjedisor" me kontributin e të gjithë anëtarëve të Grupit, si një kontribut të dobishëm për të forcuar bashkëpunimin shumë të nevojshëm midis të gjithë aktorëve të shoqërisë civile.

Shpresojmë që çështjet e përfshira në këtë gazetë dhe ato që do të pasojnë përgjatë vitit të ofrojnë rekomandime, praktika të mira, raste studimi dhe informacione të rëndësishme, për të ndihmuar agjencitë përkatëse të realizojnë vendimmarrje të informuar dhe të bazuar në prova.

Prezenca mbetet e gatshme të vazhdojë të mbështesë Shqipërinë në këtë fushë.

Ambasador Bernd Borchardt
Kryetar i Prezencës së OSBE-së
në Shqipëri

Arianna Briganti
Kreu i Departamentit
Departamenti i Mirëqeverisjes
së Çështjeve Ekonomike dhe
Mjedisore

Elton Qendro
Këshilltar për Qeverisjen
Vendore
Departamenti i Mirëqeverisjes
së Çështjeve Ekonomike dhe
Mjedisore



SHKARKIME NAFTE NË PORTO ROMANO

Teksa shumica e vendit është izoluar për shkak të parandalimit të epidemisë Covid-19, banorët e Porto Romanos kanë kaluar ditë me rradhë me tokën dhe ujin përreth të ndotur. Kjo për faktin se në datën 20 prill, një kanal vaditës është mbushur me naftë pas një aksidenti industrial, ngjarje e cila sipas banorëve është shkaktuar nga depozitat e kompanive naftënxjerrëse.

Ndotja u konstatua deri në 3 kilometra në kanalet bujqësore që shërbejnë për kullimin e tokave, të cilat më pas shkarkohen në detin Adriatik.

Ekspertët e mjedisit deklarojnë se hidrokarburet janë toksike për faunën dhe autoritetet duhet të vlerësojnë sa më parë përqendrimin e tyre pas shkarkimeve të konstatuara. Sipas Inspektoratit Shtetëror Mjedisor, shkarkimi i naftës ka ndodhur nga depozitat e kompanisë "Gega Oil", e cila pas aksidentit, ka marrë masa për pastrimin e territorit. Por aktivistët e shoqërisë civile mjedisore kanë reaguuar duke deklaruar se këto masa nuk janë të mjaftueshme. Ndërkohë, një përfaqësuese e kompanisë mohoi që derdhja e naftës të kishte ardhur si pasojë e një aksidenti industrial.

Rasti u raportua nga disa media në vend, në datat 20-27 prill 2020.

STATUSI I RASTIT

Dy inspektorë nga Inspektorati Mjedisor në Durrës janë dërguar në terren, por për shkak të ristrukturimit të institucionit, inspektimet janë pezulluar.

Sipas Policisë së Durrësit, ngjarja është referuar në Prokurori por deri tani asnjë person përgjegjës nuk është ndaluar zyrtarisht.



NAFTA MBUSH GJANICËN

Në datën 21 prill 2020, një sasi kolosale naftë është derdhur në lumin Gjanicë, teksa banorët akuzonin se autoritetet kanë ulur kontrollin, dhe si pasojë kompanitë përgjegjëse nuk mbajnë asnjë përgjegjësi.

Uji i lumit dallonte për ngjyrën e zezë të naftës, ndërsa zona përreth që ka dendësi të madhe kundërmonte nga era e rëndë përgjatë gjithë lumit.

Qytetarët janë shprehur për mediat se po vuajnë pasojat e neglizhencës së autoriteteve që gjatë periudhës së karantinës kompanitë naftënxjerrëse po e shfrytëzojnë për përfitimet e tyre.

Ndotja nuk është përhapur vetëm në lumë, por edhe në përrenj e kanale. Njësia e Inspektoratit të Shëndetit Publik në Fier fajësoi 5 fasoneri si shkaktarë të ndotjes së lumit Gjanica, teksa justifikoi kompanitë naftënxjerrëse.

Rasti u raportua nga Ora News, në datat 21-23 prill 2020.

STATUSI I RASTIT

Inspektorët e Mjedisit deklaruan se kanë nisur një hetim për të zbuluar ndotësin, që duke iu referuar edhe rasteve të ngjashme në të kaluarën, kanë qenë kompanitë naftënxjerrëse që veprojnë në zonë.

Janë inspektuar dy subjekte naftënxjerrëse, por ende nuk ka një informacion zyrtar nga autoritetet përkatëse në lidhje me çështjen.



HELMOHEN KAFSHË TË EGRA

Në 6 maj 2020, Shoqata Ornitologjike e Shqipërisë (AOS) raportoi dy kadavra të Baldosës (*Meles meles*), të cilat dyshoheshin si raste helmimi (Kavajë dhe Durrës). Për ta vërtetuar nëse kishim të bënim me raste të helmimit, AOS ndoqi protokollin anti-helmim, që konsiston në marrjen e mostrave nga dheu, poshtë dhe në afërsi të kadvrës në një thellësi prej 5 cm, marrjen e mostrave nga insektet përreth, si dhe në investigimin për prani të karremave helmues dhe për prani të ambalazheve të substancave toksike (qese, shishe) në afërsi të kadvrës. Ndërkohë, kadavra u gropos, në pamundësi për t'iu dërguar laboratorit për kryerjen e nekropsisë dhe analizave toksikologjike, për shkak të situatës së pandemisë. Groposja e kadvrës është e domosdoshme në rastet kur dyshohet për helmim, pasi në këtë mënyrë parandalohet helmimin e shumë kafshëve të tjera që ushqehen me kërkma. Raportimi i rasteve të tilla është mjaft i rëndësishëm, pasi na jep informacion për shkallën dhe shtrirjen e helmimit të faunës së egër në vend, që sot është një faktor shumë kërcënues për të gjitha kafshët mishngrënëse përfshirë shqiponjat, shkabat e shumë shpendë të tjerë shpesh të rrezikuar me zhdukje.

Rasti u raportua nga Shoqata Ornitologjike e Shqipërisë (AOS)

STATUSI I RASTIT

Për kryerjen e analizave toksikologjike të mostrave të marra, AOS iu drejtua Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare (ISUV), ku mësuam se laboratorit përgjegjës për analizat toksikologjike nuk është më funksional, për shkak të kostove të larta të analizave dhe pajisjeve. Në këto kushte, duket se e vetmja mundësi për kryerjen e analizave mbeten laboratorët e vendeve fqinje, si psh. Greqia.



SHKATËRRIMI I HABITATEVE NË MUNELLË

Rajoni i Munellës dhe pse i propozuar për t'u shpallur zonë e mbrojtur për nga vlerat e larta të biodiversitetit dhe rëndësisë që ka për një nga nënpopullatat e rrëqebullit të Ballkanit në vendin tonë, vazhdon të jetë nën presionin e shkatërrimit të habitatit gjatë muajve të parë të vitit 2020.


Në brendësi të kufijve të propozuar, në fshatrat Kryezi dhe Gojan janë konstatuar vazhdimisht prerje të paligjshme pyjesh.

Për gati një javë, prej 13 majit, në fshatin Xhuxhë, sipërfaqe të mëdha pyjesh janë djegur qëllimisht duke prekur qindra hektarë të zonës pyjore dhe një pjesë të korridorit kryesor të kalimit të rrëqebullit të Ballkanit. Dëmtimi i sipërfaqes pyjore në një zonë kaq të rëndësishme ka një ndikim të drejtpërdrejtë mbi ekosistem, duke shkaktuar prishjen e habitatit të riprodhimit dhe vrasjen e shumë llojeve të jetës së egër.

Rasti u raportua nga Shoqata e Ruajtjes dhe e Mbrojtjes së Mjedisit Natyror në Shqipëri (PPNEA).

STATUSI I RASTIT

Lënda drusore e prerë në fshatin Kryezi është sekuestruar nga Bashkia Fushë-Arrëz, por asnjë autor i ngjarjes nuk është bërë i ditur. Prerjet në Gojan janë raportuar pranë Inspektoratit Mjedisor por për shkak të ristrukturimit të institucionit, hetimi nuk mund të vazhdohej.



NGJARJE TË RËNDËSISHME



24 janar - Takimi Kombëtar për Luftimin e Helmimit dhe Krimit ndaj Faunës së Egër në Shqipëri organizuar nga AOS, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ambasada Spanjolle në Shqipëri.
www.aos-alb.org



4 shkurt - Prezantohet publikimi i Rastit studimor "Vlerësimi Pasuror i Krimeve Mjedisore në Shqipëri" nga EcoAlbania
www.ecoalbania.org



12 shkurt - Konferenca e 5-të Ndërkombëtare Shkencore mbi Krimin Mjedisor, Sigurinë Mjedisore dhe Sigurinë Kombëtare, organizuar nga Akademia e Sigurisë në bashkëpunim të ngushtë me Prezencën e OSBE-së në Shqipëri.
www.asp.gov.al



TË NJOHIM LEGJISLACIONIN

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë
KREU IV
VEPRA PENALE KUNDËR MJEDISIT

Neni 206/a

Shkatërrimi me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor (Shtuar me ligjin nr. 10 023, datë 27.11.2008; ndryshuar fjalët në paragrafin e parë, dytë dhe të tretë me ligjin nr. 144/2013, datë 2.5.2013) Shkatërrimi apo dëmtimi me dashje, me pasoja të rënda materiale, i fondit pyjor, i fidanishtes pyjore, i grumbullit pyjor ose i çdo njësie të ngjashme me to, me zjarr, dënohet me burgim nga pesë deri në tetë vjet. Po kjo veprë, e kryer me qëllim ndryshimin e kategorisë dhe destinacionit të tokës, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet. Po kjo veprë, kur ka shkaktuar pasoja të rënda për pronën, shëndetin ose jetën e njerëzve apo shkakton dëme të rënda dhe të zgjatura në kohë ndaj mjedisit apo zonave të mbrojtura, dënohet me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet.

KONTAKTE

Qendra Burimore e Mjedisit në Shqipëri
✉ info@recshqiperi.org
🌐 www.recshqiperi.org